



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 245, Datë 28.08.2026

MBI

**MODIFIKIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI
FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 100 MW**

Në mbështetje të neneve 16, 51 dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”; nenit 11, pika 3 e ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; neneve 13, 14, pika 9 dhe 15 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; “Rregullave për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026, si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 28.08.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1611/11 prot., datë 27.08.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW”,

Konstatohet se:

1. Të dhëna për shoqërinë

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. është licencuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, i ndryshuar, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 100 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611 prot., datë 15.05.2026, shoqëria ka paraqitur kërkesën për modifikimin e licencës së saj, dhe shtimin e veprave ndihmëse në Aneksin A të licencës, pa ndryshuar kapacitetin total të centralit, prej 100 MW.
- Ky aplikim vjen në rrethanat kur shoqëria disponon Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 673, datë 30.10.2024 dhe Kontratën nr. 1192 rep., nr. 482 kol., datë 11.11.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 100 MW dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni, në Zonën Kadastrale nr. 1451, Fshati Darzezë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, Qarku Fier, nga shoqëria “SUNNY SIDE ENERGY” sh.p.k.”, si dhe referuar përcaktimeve të pikës 3 të nenit 11, të ligjit nr. 24/2023.
- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 145, datë 28.05.2026, vendosi të fillojë procedurën për modifikimin e licencës së shoqërisë për prodhimin e energjisë elektrike.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 30.05.2026 dhe 01.06.2026) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 29.06.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.
- ERE, me shkresën nr. 1611/3 prot., datë 03.06.2026, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe Operatorin e Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a., për fillimin e kësaj procedure. Nga ana e AKM-së dhe OST sh.a. nuk rezultoi të ketë pasur kthim përgjigjeje.
- Në lidhje me përgjigjet e institucioneve të njoftuara, nga ana e MIE-s është përcjellë qëndrimi, sikurse më poshtë referuar, por gjithsesi, njohja në kuadër të kësaj procedure nuk i zhvesh subjektet nga detyrimet e tjera, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 59/2026, si dhe të “*Rregullave për regjistrimin në ERE të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 230, datë 18.08.2026.
- Me shkresën nr. 1611/4 prot., datë 03.06.2026, ERE ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së saj, si dhe i ka bërë me dije në lidhje me informacionin/dokumentacionin që duhet të plotësohet në aplikim.
- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1611/5 prot., datë 15.06.2026, shoqëria ka depozituar informacionin /dokumentacionin e kërkuar.
- Në vijim, me shkresën nr. 4755/1 prot., datë 29.06.2026, protokolluar në ERE me nr. 1291/9 prot., datë 01.07.2026, MIE ka bërë me dije, ndër të tjera se, referuar të drejtës për ndërtim të lëshuar nga MIE dhe parashikimeve të kontratës së nënshkruar ndërmjet palëve në vijim, çdo ndryshim në projekt, përfshirë shtimin e veprave ndihmëse dhe/ose njësive të depozitimit të energjisë elektrike, duhet të trajtohet në përputhje me kushtet kontraktuale dhe kuadrin rregullator në fuqi, duke sjellë në vëmendje të ERE-s për të mbajtur në konsideratë këtë qëndrim për të gjitha njoftimet e vendimeve të bordit të ERE-s lidhur me modifikimin e licencave për shtimin e veprave ndihmëse/njësive të depozitimit të energjisë elektrike.
- Me shkresën nr. 1611/7 prot., datë 14.07.2026, ERE i ka përcjellë shoqërisë qëndrimin e MIE-s dhe i ka kërkuar depozitimin e qëndrimit përkatës të MIE-s lidhur me shtimin e veprave ndihmëse dhe njësive të depozitimit të energjisë elektrike.
- Me vendimin nr. 206, datë 21.07.2026, bordi i ERE-s ka vendosur pezullimin e procedurës deri në administrimin nga ERE të qëndrimit të MIE-s, por jo më shumë se 30 (tridhjetë) ditë nga hyrja në fuqi e vendimit. Ky vendim i është njoftuar shoqërisë nëpërmjet shkresës së ERE nr. 1611/9 prot., datë 29.07.2026.
- Me shkresën nr. 4755/11 prot., datë 03.08.2026, protokolluar në ERE me nr. 1611/10 prot., datë 05.08.2026, MIE ka sqaruar se, për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese që nuk janë objekt koncesioni, zbatohen rregullat dhe procedurat e VKM-së nr. 822/2015, e ndryshuar. Për impiantet e depozitimit të energjisë elektrike, MIE ka referuar zbatimin e nenit 51, pikat 3, 4 dhe 5 të ligjit nr. 59/2026, “*Për sektorin e energjisë elektrike*”, sipas të cilit impiantet në zhvillim ose operim në hyrjen në fuqi të ligjit, pa licencën përkatëse, njihen dhe lejohen të operojnë sipas licencës ekzistuese, në kushtet dhe afatet e përcaktuara nga ky nen. Në përfundim, MIE vlerëson se shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. mund të vijojë operimin sipas licencës ekzistuese, në përputhje me nenin 51 të ligjit nr. 59/2026.
- Me administrimin e qëndrimit të MIE-s, konsiderohet i përmbushur kushti mbi të cilin ishte bazuar pezullimi i procedurës me vendimin e bordit të ERE-s nr. 206, datë 21.07.2026.
- Në kushtet kur impianti i depozitimit të energjisë elektrike i deklaruar nga shoqëria i nënshtrohen regjimit të posaçëm kalimtar të përcaktuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026, njohja

e tij dhe vijimi i përkohshëm i operimit sipas licencës ekzistuese, në kuptim të pikës 3 të këtij neni, nuk zëvendëson licencën e posaçme për operimin e impiantit të depozitimit, si dhe nuk përbëjnë pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës së prodhimit. Për rrjedhojë, shqyrtimi i kërkesës së shoqërisë nga ERE kufizohet në përmbushjen e kriterëve dhe kërkesave të tjera ligjore dhe rregullatore të zbatueshme për modifikimin e licencës.

- Referuar dokumentacionit të administruar, përmbushjes së kërkesave të ERE-s gjatë shqyrtimit të aplikimit dhe qëndrimit të MIE-s të përcjellë me shkresën nr. 4755/11 prot., datë 03.08.2026, vlerësohet se janë përmbushur kushtet ligjore dhe rregullatore për miratimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për modifikimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike.
- Për sa më sipër, vlerësohet që, të licencuarit t’i lihet detyrë të sigurojë që gjatë të gjithë kohës së operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, i përbërë nga 20 njësi me kapacitet energjetik 5,015 MWh secila dhe kapacitet energjetik total 100,3 MWh; të mos tejkalojë kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar prej 100 MW, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.
- E drejta e operimit të impiantit të depozitimit të energjisë elektrike, i njihet shoqërisë, sipas licencës ekzistuese, deri në përfundim të periudhës 12-mujore të përcaktuar në nenin 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda së cilës shoqëria duhet të aplikojë për licencë për operimin e impiantit të depozitimit sipas legjislacionit në fuqi.
- Po ashtu, duke qenë se me vendimin nr. 230, datë 18.08.2026, ERE ka miratuar “*Rregullat për njoftimin dhe regjistrimin pranë ERE-s të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike gjatë regjimit kalimtar*”, vlerësohet se informacioni dhe dokumentacioni i administruar në këtë procedurë mund të përdoret edhe për qëllimet e njoftimit dhe regjistrimit, duke u plotësuar, kur është e nevojshme, me dokumentacionin shtesë të kërkuar. Njoftimi dhe regjistrimi duhet të trajtohen si detyrim i veçantë i operatorit sipas nenit 51, pika 5, të ligjit nr. 59/2026, brenda afatit ligjor 60-ditor nga hyrja në fuqi e ligjit. Përmbushja e këtyre kërkesave do të trajtohet në kuadër të procesit të njoftimit dhe regjistrimit dhe nuk përbën pengesë për vijimin dhe përfundimin e procedurës së modifikimit të licencës.
- Nga analiza e aplikimit rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “*Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë me vendimin e bordit të ERE-s nr. 13, datë 16.01.2025, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 100 MW, duke reflektuar në Aneksin A të licencës impiantin e depozitimit të energjisë elektrike (BEES), të përbërë nga 20 (njëzet) njësi me kapacitet energjetik 5,015 MWh secila dhe kapacitet energjetik total 100,3 MWh.

2. Impianti i depozitimit të energjisë elektrike (BESS), i përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, për periudhën kalimtare njihet dhe lejohet të vijojë operimin në kuadër të licencës ekzistuese të prodhimit, në përputhje me nenin 51, pika 3, të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Reflektimi i tij në licencën e prodhimit nuk përbën dhe nuk zëvendëson licencën për operimin e implantit të depozitimit të energjisë elektrike, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
3. Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k. ka detyrimin të sigurojë që, gjatë operimit të centralit fotovoltaiik dhe implantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), fuqia aktive totale e injektuar në pikën e lidhës në rrjet nga centrali fotovoltaiik dhe impianti i depozitimit, në asnjë moment, të mos tejkalojë 100 MW, përkatësisht kapacitetin e instaluar të centralit fotovoltaiik të licencuar, si dhe të respektojë kushtet dhe kufizimet teknike të përcaktuara nga operatori i rrjetit.
4. E drejta për vijimin e operimit të implantit të depozitimit të energjisë elektrike (BESS), sipas pikës 2 të këtij vendimi, i njihet shoqërisë vetëm për periudhën kalimtare të parashikuar në nenin 51 të ligjit nr. 59/2026 “Për sektorin e energjisë elektrike”. Shoqëria ka detyrimin që, brenda afatit 12-mujor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 51 të këtij ligji, të paraqesë pranë ERE-s aplikimin për licencimin e veprimtarisë së operimit të implantit të depozitimit të energjisë elektrike, në përputhje me legjislacionin dhe aktet rregullatore në fuqi.
5. Përfundimi i periudhës kalimtare të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi nuk krijon të drejtë për vijimin e operimit të implantit të depozitimit të energjisë elektrike në kuadër të licencës së prodhimit, përtej rasteve dhe kushteve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.
6. Ky vendim është objekt rishikimi në rast se rezulton se të dhënat, dokumentacioni ose rrethanat mbi të cilat është bazuar vendimmarrja e bordit të ERE-s kanë ndryshuar ose nuk përputhen me gjendjen faktike dhe juridike të impianteve të depozitimit të energjisë elektrike.
7. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancive të Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), Agjencinë Kombëtare të Mjedisit (AKM) dhe shoqërinë “Operatori i Sistemit të Transmetimit” (OST) sh.a. për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrît AHMETI